



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	01.09.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHUK	5915	2023	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.996/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.996/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 14.06.2023 të shqiptuar nga Koordinator i Komisionit për Legjislacioni, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 01.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.996/2023 e datës 14.07.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. **Anulohet** masa disiplinore "Vërejtje" e datës 14.06.2023 e shqiptuar ndaj ankueses nga Koordinator i Komisionit për Legjislacioni, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

III. **Obligohet** Drejtori i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale dhe regjistri përkatës i nëpunësit civil, masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar sipas Akt Emërimit DKR-01/7-15 të datës 02.12.2015 në pozitën "Zyrtare e Fushës në Komisionin Parlamentar" në kuadër të Drejtorisë për Mbështetje Komisioneve Parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në këtë rast Koordinatori i Komisionit për Legjislacioni, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në Kuvendin e Republikës së Kosovës më datë 14.06.2023 i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" lidhur me moskryerjen e detyrave të punës.

Ankuesja kundër kësaj mase më datë 14.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5252/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se masa është jo ligjore dhe tendencioze duke kërkuar që e njëjta të largohet nga dosja personale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 26.07.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5252/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Masën disiplinore "Vërejtje" e datës 14.06.2023 të shqiptuar ndaj ankueses; Emailin e datës 30.12.2022 nga V.K për ankuesen dhe M.K; Emailin e datës 27.12.2022 nga M.K për F.H; Emailin e datës 30.12.2022 nga V.K për ankuesen; Emailin e datës 29.12.2022 nga ankuesja për V.K; Emailin e datës 29.12.2022 nga V.K për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 26.07.2023; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses nga V.K e datës 14.06.2023 për M.H dhe L.D; Emailin e datës 30.05.2023 nga V.K për G.L; Emailin e datës 30.05.2023 nga G.L për V.K; Vendimin me Nr. SP.12-01/22 i datës 13.12.2022; Emailin e datës 15.06.2023 nga V.K për M.H; Akt Emërimit DKR-01/7-15 të datës 02.12.2015; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 26.01.2023 dhe 31.01.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për Zyrtar të Fushës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës, konstatoi se janë të bazuar pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 14.06.2023, pretendon që kjo masë është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase është tendencioze dhe e pa argumentuar.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të vlerësimit të kësaj çështje juridike-administrative, lidhur me kualifikimin e shkeljeve disiplinore ju referuar dispozitave të nenit 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbyshja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbyshjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbyshjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".

Referuar dispozitave të lartcekura si dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit përmes të cilit ankueses i është shqiptuar masa disiplinore "Vërejtje" e datës 14.06.2023, Kolegji i Këshillit, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, masën disiplinore të kontestuar me këtë ankesë e ka shqiptuar duke u thirrur në nenin 47 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Rrjedhimisht bazuar në këtë Kolegji, vlerëson se masa disiplinore "Vërejtje", bazuar në legjislacionin në fuqi të zyrtarëve publik i shqiptohet vetëm për shkelje të lehta disiplinore që ndërlidhen me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkritazi me këtë mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankueses në përmbajtje të ankesës i referohet mospërmbyshjes së detyrave të punës e që nënkupton që këto shkelje të supozuara nga mbikëqyrësi nuk rezultojnë se parashihen te paragrafi 4 i nenit 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, për të cilat mund të shqiptohet masa disiplinore "Vërejtje".

Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit civil, në këtë rast ankueses, në rast se konstaton se veprimet e nëpunësit civil bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi, fillimisht

është i obliguar që të bëjë kualifikimin e shkeljeve disiplinore (a janë shkelje të rënda apo të lehta) dhe të konstatoj në mënyrë të drejtë se cilat dispozita ligjore janë cenuar me veprimet e nëpunësit civil respektivisht ankueses, ndërsa në rastin konkret të ankueses mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk ka ndërmarr veprimet e tilla duke bërë kualifikim jo të duhur të shkeljes disiplinore, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të kësaj mase nënkuptohet që e njëjta është shqiptuar për moskryerjen e detyrave të punës, e në fakt kjo nuk konsiderohet shkelje e lehta disiplinore.

Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses më rastin e shqyrtimit të masës disiplinore "Vërejtje" të datës 14.06.2023, ka vepruar në kundërshtim me nenin 46, 47, 48 dhe 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe e njëjta është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht për shkak të shkeljeve procedurale në këtë procedurë disiplinore Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në shkelje materiale, gjegjësisht nuk është lëshuar në atë nëse ankuesja ka bërë shkelje disiplinore, si rezultat i kësaj pretendimet e ankueses janë të bazuara, kështu që Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, është i obliguar që të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankueses nga dosja personale e saj sipas këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.996/2023, datë 01/09/2023.

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Drejtorit të Burimeve Njerëzore në Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.